

# Haemophilus Influenzae tipi b

## Çfarë është Hib (Haemophilus influenzae tipi B)?

Haemophilus influenzae b (Hib) është një bakter që mund të shkaktojë infeksion të rëndë te njerëzit, veçanërisht te fëmijët, por edhe tek individët me sistem imunitar të dobësuar ose ata që nuk kanë shpretkë ose ku shpretkë është e dëmtuar nga sëmundjet.

## Si infektohen njerëzit me Hib?

Infeksioni *Haemophilus influenzae* b shkaktohet nga një bakter ngjitës. Ai përhapet përmes ajrit nga kollitja ose teshtitja ose edhe nga frymëmarrja. Bakteret mund të jetojnë në hundë dhe fyt — duke mos shkakuar asnjë dëm. Ndonjëherë bakteret mund të hyjnë në qarkullimin e gjakut dhe të përhapen në tru ose në kocka. Ky quhet infeksion invaziv Hib.

Sëmundja Hib është më e zakonshme te fëmijët nën 4 vjeç. Fëmijët nën një vjeç janë veçanërisht të rrezikuar.

## Cilat janë simptomat e infektimit me Hib?

Hib mund të shkaktojë sëmundje të rëndë duke përfshirë

- Meningjit (inflamacion i cipës rrethuese të trurit)
- Septicemi (helmimi i gjakut)
- Epiglotit (ënjtje në fyt që shkakton mbytje)
- Osteomielit (infeksion i kockave)

## Kush duhet ta marrë vaksinën Hib?

Sëmundja Hib mund të parandalohet me anë të vaksinimit.

Të gjithë fëmijët duhet ta marrin vaksinën Hib në moshën 2, 4, 6 dhe 13 muajshe.

Vaksina Hib u jepet fëmijëve si pjesë e [vaksinës 6 në 1](#) në moshën 2, 4 dhe 6 muajshe. Vaksina 6 në 1 mbron nga difteria, hepatiti B, Hib, pertusis (kolla e mirë), poliomieliti dhe tetanozi.

Një vaksinë përforcuese Hib jepet në moshën 13 muajshe në të njëjtën kohë me vaksinën MenC. Kjo siguron mbrojtje shtesë kundër infeksionit Hib. Vaksinat jepen si një vaksinë e kombinuar Hib/MenC.

## Kush nuk duhet ta marrë vaksinën Hib?

Ka shumë pak njerëz që nuk duhet ta marrin vaksinën Hib. Fëmija juaj nuk duhet ta marrë vaksinën nëse ka pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) ndaj një doze të mëparshme të vaksinës ose ndonjë pjesë të vaksinës.

## Çfarë duhet pritur pas marrjes së vaksinës Hib?

Pas marrjes së vaksinës, fëmija juaj mund të ketë siklet, skuqje ose ënjtje rreth vendit ku është bërë injeksioni. Ai mund të jetë nervoz dhe të ketë temperaturë.

## HSE - Zyra Kombëtare e Imunizimit

Nëse kjo ndodh, ju mund t'i jepni atij paracetamol ose ibuprofen. Ju gjithashtu duhet t'i jepni atij shumë lëngje për të pirë. Sigurohuni që ai nuk është shumë i ngruhtë dhe që rrobat e tij nuk fërkohen në vendin e injektimit.

Fëmijët zakonisht shërohen nga këto efekte anësore të vogla brenda një ose dy ditësh

Nga fëmijët që imunizohen;

- 1 në 5 do të ketë siklet, skuqje dhe ënjtje në vendin ku është bërë injeksioni
- 1 në 50 do të ketë temperaturë.

Efektet anësore të rënda janë shumë të rralla.

### Si funksionon vaksina Hib?

Vaksina Hib përmban ekstrakte nga bakteret *Haemophilus influenzae tipi b*. Vaksina funksionon duke e bërë sistemin imunitar të trupit të përgjigjet nëse personi i vaksinuar bie në kontakt me bakteret *Haemophilus influenzae tipi b*, pa shkaktuar sëmundje.

### Sa efektive është vaksina Hib?

Midis 95% dhe 100% e fëmijëve bëhen imunë ndaj Haemophilus Influenzae b (Hib) pasi të kenë përfunduar kalendarin e rekomanduar të vaksinave.

### Ku mund të mësoj më shumë?

Flitni me një punonjës profesionist shëndetësor të besuar dhe vizitoni [www.immunisation.ie](http://www.immunisation.ie)